



BASHKIA BERAT

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2025-2027

BASHKIA BERAT

MESAZH NGA KRYETARI I BASHKISË

Të nderuar banorë dhe të rinj të Bashkisë Berat:

Me entuziazëm dhe optimizëm të madh paraqes para jush Planin Lokal të Veprimit për Rininë 2025-2027, një iniciativë që mbështet, fuqizon dhe angazhon të rinjtë e komunitetit tonë.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë doli si një nevojë për të planifikuar më mirë dhe për të vepruar me efektivitet dhe efikasitet për fuqizimin e rinisë, për t'ju mundësuar të rinjve të Beratit një pjesëmarrje aktive në vendim-marrjen lokale, një jetë të shëndetshme dhe të pasur sociale, kulturore dhe sportive, si aftësimin për jetën dhe punësim apo vetë-punësimin. Plani kontribuon drejtpërsëdrejti në arritjen e misionit të Bashkisë që është *“Vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat”*.

Të rinjtë janë e tashmja dhe e ardhmja e bashkisë sonë. Prandaj është e rëndësishme që të kemi një plan për t'i mbështetur ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Të rinjtë kanë energji, vitalitet, ide të mëdha, talent dhe aftësi për t'i realizuar ato. Ky Plan reflekton nevojat, prioritetet dhe ambiciet e tyre. Plani thekson nevojën për të punuar së bashku me të rinjtë, aktorët lokalë, si dhe pushtetin qendror për realizimin e tyre.

Plani është rezultat i një procesi konsultimi që përfshiu seminare, takime dhe intervista, si dhe një anketë me të rinjtë. Plani është strukturuar përreth objektivave të vendosura për arritjen e prioritetëve— organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore; mirëqenia aktive fizike dhe mendore e të rinjve; dhe aftësimi dhe punësimi rinor.

Plani u hartua nga Bashkia Berat në bashkëpunim me shoqatën Ura të Reja në kuadrin e projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, modelon të ardhmen”, mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Kryetari
Ervin Demo



PËRMBAJTJA

1. Qëllimi, metodologjia dhe kuadri i zhvillimit të Planit Lokal të Veprimit për Rininë	2
1.1. Qëllimi dhe metodologjia	6
1.2. Kuadri i zhvillimit të Planit Lokal të Veprimit për Rininë	6
2. Bashkia Berat	4
2.1. Zhvillimi social-ekonomik dhe demografia	6
2.2. Shërbimet dhe infrastruktura për rininë	8
2.3. Nevojat e të rinjve të Bashkisë Berat	8
3. Çfarë do të bëjmë për të rinjtë?	15
3.1. Çfarë kërkojnë të rinjtë?	15
3.2. Çfarë mendon përfaqësuesit e shërbimeve publike për të rinjtë?	18
3.3. Vizioni dhe misioni i Bashkisë Berat për të rinjtë	21
3.4. Prioritetet, qëllimet, objektivat dhe masat kryesore.....	22
• Prioriteti 1: Fuqizimi dhe organizimi rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore.	
• Prioriteti 2: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve.	
• Prioriteti 3: Aftësimi dhe punësimi i të rinjve.	

PRIORITETET TONA:

Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore



Të rrisim pjesëmarrjen e të rinjve në vendim-marrjen lokale.

Mirëqenia aktive fizike dhe mendore e të rinjve



Të sigurohen kushtet e nevojshme për një jetë aktive, të shëndetshme fizike, sociale dhe mendore e të rinjve të Bashkisë Berat.

Aftësimi dhe punësimi rinor



Të rrisim mundësitë e të rinjve për punësim dhe vetë-punësim në bashkinë Berat.

1. QËLLIMI, METODOLOGJIA, KUADRI I ZHVILLIMIT TË PLANIT LOKAL TE VEPRIMIT PER RININE

1.1. Qëllimi dhe metodologjia

Plani Lokal i Veprimit për Rininë është një instrument udhëheqës për Bashkinë në punën e saj me dhe për të rinjtë, komunitetin, ofruesit e shërbimeve për të rinjtë dhe palët e tjera të interesuara për të plotësuar nevojat e të rinjve të Beratit dhe për të krijuar një qytet miqësor kundrejt të rinjve.

Objektivat e Planit Lokal të Veprimit për Rininë janë:

- ✓ Identifikimi i nevojave të të rinjve të Bashkisë Berat lidhur me shërbimet, mjediset dhe programet.
- ✓ Adresimi i nevojave të të rinjve në fushat prioritare duke vendosur objektiva specifike ambicioze dhe të arritshme si dhe masa konkrete për arritjen e tyre.
- ✓ Identifikimi i mundësive të koordinimit dhe bashkëpunimit me aktorët e tjerë lokalë, qeveritarë dhe jo-qeveritarë, si dhe pushtetin qendror për adresimin e nevojave të të rinjve.

Ky Plan është realizuar me përfshirje të gjerë të vetë të rinjve si dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, të cilët marrin pjesë në realizimin e shërbimeve për rininë. Metodologjia e përdorur për

zhvillimin e këtij Plani përfshin rishikimin e dokumenteve, shqyrtimin e modeleve të suksesshme dhe planet e veprimit të zhvilluara nga bashkia dhe aktorë të tjerë, intervista gjysmë të strukturuar, grupe fokus, dhe anketë. Proçesi u lehtësua nga ekspertët e angazhuar nga projekti “Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, modelon të ardhmen”, mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe zbatuar nga shoqata Ura të Reja.

Faza 1: Shqyrtimi legjislacionit aktual, veçanërisht i Ligjit “Për rininë”, Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe i Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe dokumenteve të tjera strategjike që lidhen me rininë. Identifikimi i hapave konkretë nga qeverisja vendore për zbatimin në nivel lokal të legjislacionit dhe politikave kombëtare.

Faza 2: Përfshirja e të rinjve për identifikimin e nevojave, shqetësimeve dhe problematikave të tyre. Të rinjtë e përfshirë janë përfaqësuesit e Këshillit Vendor të Rinisë të Bashkisë Berat, të rinjtë e angazhuar në aktivitetet e Qendrës Multifunktionale Rinore Berat, shoqatës rinore Ura të Reja që vitet e fundit ka qenë organizata më aktive e shoqërisë civile në Berat, etj. Tre fusha prioritare u identifikuan dhe u vendosën në bazë të strukturës së Planit: Organizimi, fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore; Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale & mendore e të rinjve; Aftësimi dhe punësimi i të rinjve. Një draft i parë i Planit Lokal të Veprimit për Rininë u zhvillua.

Faza 3: Konsultimi me strukturat e Bashkisë dhe aktorët e tjerë lokalë lidhur me problematikat për rininë dhe zgjidhjen e tyre. Në këtë kontekst, u zhvilluan takime me personat përgjegjës të strukturave përgjegjëse, sidomos stafin e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Rinisë në Bashkinë Berat dhe të Qendrës Rinore Berat. U identifikua gjendja ekzistuese lidhur me politikat dhe burimet lokale për plotësimin e nevojave të rinisë, mangësitë dhe potencialet. Kontributi i përfaqësuesve lokalë u reflektua në draftin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë.

Faza 4: Aprovimi nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak. Në këtë fazë, versioni përfundimtar i Planit Lokal të Veprimit për Rininë i është dorëzuar Kryetarit të Bashkisë Berat dhe Këshillit Bashkiak për aprovim.

1.2. Kuadri i zhvillimit të PLVR

Plani Lokal i Veprimit për Rininë është në zbatim të drejtpërdrejtë të Ligjit “Për Rininë” (75/2019) dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022-2029.

Ligji “Për Rininë” ngarkon përgjegjësi specifike për njësitë e qeverisjes vendore të cilat, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- krijimin e këshillit vendor të rinisë;

- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Një objektivë i **Strategjisë Kombëtare të Rinisë** është që “të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike” (Objektivi Specifik 1.1). Në këtë kontekst duhet të forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje.

Gjithashtu Strategjia kërkon që «të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore, sociale, fizike dhe seksuale» (Objektivi Specifik 3.2). Ndërsa Objektivi Specifik 3.3 thekson se «Të rejtat dhe të rinjtë të

mbështeten në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri duke pasur mundësi për strehim dhe argëtim (në kulturë, art dhe sport)», nëpërmjet ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi edhe në kohën e lirë.

2. BASHKIA BERAT

2.1. Zhvillimi social-ekonomik dhe demografia

Bashkia Berat bën pjesë në Qarkun e Beratit. Bashkia Berat, është qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e Qarkut Berat. Bashkia e Beratit shtrihet në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum, i cili kalon përmes qytetit të Beratit. Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka një sipërfaqe prej 22.4 km² prej së cilës sipërfaqe urbane janë 6.3 km². Shtrirja në këto dy krahina të ndryshme fiziko-gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fizikogjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peizazheve gjeografike. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416 m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 meters).

Bashkia Berat, përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Beratit dhe njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë. Sipërfaqja e Bashkisë Berat është 380 km². Bashkia Berat kufizohet në veri me Bashkinë Kuçovë, në lindje me Bashkinë e Gramshit, në

juglindje me Bashkinë Poliçan e Skrapar, në perëndim me Bashkinë Mallakastër e Fier.

Berati njihet për arkitekturën, vlerat historike, kulturore, artistike dhe fetare. Berati është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë). Historia 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë. I shpallur “Qytet Muze” në vitin 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore.

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia dhe turizmi. Vlerat e spikatura turistike të cilat lidhen me qytetin muze 2,400 vjeçar të Beratit, parkun kombëtar të Tomorrit dhe mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur janë kthyer në mundësi punësimi dhe zhvillimi ekonomik për Beratin.

Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicionit gjeografik, traditës historike, resurseve që mbart në këtë fushë dhe aksesit me rrugët kombëtare. Biznesi i madh përbën 23 % të totalit të numrit të bizneseve (2,314), biznesi i vogël përbën 74 % dhe ai ambulant dhe institucionet 3% të tij. Njësia Administrative Berat ka 1809 ose 78% e totalit, nga të cilat biznesi i vogël 1363 subjekte dhe 446 subjekte biznesi i madh. Subjektet e biznesit të madh zënë 83% të totalit të biznesit të madh. Subjektet e biznesit të vogël zënë 77% të totalit të biznesit të vogël. Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, ku janë të punësuar 66.9% e numrit total të të

punësuarve, pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqësia me 4.1 %.

Njesitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqësinë, me fokus në kultivimin e pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë, blegtorinë dhe përpunimin e produkteve të mishit dhe qumështit. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi zë vlerën 90%. Njësia Otlak ka 296 biznese në total ose 13% të totali, prej të cilave 66 biznese të mëdha dhe 230 biznese të vogla që shprehur në përqindje ndaj totalit të bashkisë janë biznesi i madh 12% dhe 13% biznesi i vogël. Njësia Velabisht ka 6% të numrit total ose 147 biznese nga të cilat 2% të totalit të biznesit të madh ose 10 biznese dhe 8% të totalit të biznesit të vogël ose 137 biznese.

Sipas të dhënave të Zyrës së Punës janë 1,100 individë, banorë të Bashkisë Berat, që në vitin 2022 rezultojnë të rregjistruar në Zyrën e Punës. Karakteristikat kryesore të punëkërkuësve të papunë janë: 86% e punëkërkuësve jetojnë në territorin e qytetit Berat, ndërsa 14% në njësitë e tjera administrative. Njësitë administrative Otlak dhe Velabisht kanë fasonë në afërsi dhe kanë mundësi punësimi. Banorët e Roshnikut dhe Sinjës e kanë të pamundur të vijnë në qytet për të punuar për shkak të distancës dhe kostos së transportit. Ndërkohë, rreth 50% e punëkërkuësve kanë moshë nën 40 vjeç. Në fakt projektet për nxitjen e punësimit kanë target grupmoshat deri në 35 vjeç.

Bashkia Berat ka një popullsi prej 99,724 banorë (sipas Gjendjes Civile të vitit 2023), nga të cilët 63,470 janë në qytetin e Beratit. Ndërsa sipas Censit 2023, në Bashkinë Berat janë 62,232 banorë

(31,181 femra ose 50%), ku 39,011 janë të moshës 15-64 vjeç dhe 8,799 janë të moshës 0-14 vjeç.

2.2. Shërbimet dhe infrastruktura për rininë

Strukturat e bashkisë përgjegjëse për të rinjtë janë Drejtoria Arsimit, Kulturës dhe Rinisë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Qendra Multifunkionale Rinore si njësi zbatuese.

Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë, e cila ka 5 punonjës, përfshirë Drejtorin, specialistin e kulturës, dy specialistë të arsimit, specialistin për rininë si dhe Qendrën Rinore me katër punonjës për rininë. Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë është përgjegjëse për administrimin e çështjeve të lidhura me grupmoshën e të rinjve duke u mbështetur në strategji dhe politika kombëtare dhe ndërkombëtare. Punohet vazhdimisht me një qasje sa gjithëpërfshirëse, po aq edhe të dedikuar ndaj target grupeve të shoqërisë; në përputhje me nevojat e identifikuara të tyre; për ofrimin e kushteve dhe standardeve optimale të shërbimeve në territorin e Bashkisë Berat, duke synuar mbështetjen e aktiviteteve që nxisin jetesën aktive, të shëndetshme, sociale, të sigurt e gjithëpërfshirëse.

Në kuadër të kësaj, ofrohen programe të rritjes së kapaciteteve dhe aftësive nëpërmjet njohjes së profesioneve, këshillimit të karrierës, aftësimit jetësor, aktiviteteve të edukimit joformal për njohjen dhe eksplorimin e vetvetes, programe të rritjes së kapaciteteve në fusha të ndryshme artistike. Mirëqenia dhe siguria fizike e sociale, si dhe

ajo mendore e psiko-emocionale e grupeve të të rinjve dhe fëmijëve, vlerësohet si parësore

Programet e hartuara dhe implementuara fokusohen tek sesionet informuese dhe edukuese mbi shëndetin mendor e atë emocional, çështjet e zhvillimit, nxitjen edhe promovimin e talenteve sportive e krijimtarisë artistike; duke synuar në tërësi të së gjithës motivimin dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme të aftësive vendimtarëse demokratike dhe të lidhshimit në një mjedis miqësor për të rinjtë dhe fëmijët.

Bashkia Berat koordinon dhe bashkëpunon me organizatat dhe projektet jo-fitimprurëse për implementimin e aktiviteteve në ambientet e Qendrës Multifunkionale Rinore. Përgjatë vitit 2024 ka bashkëpunuar me organizatën “Ura të Reja” për realizimin e aktiviteteve të projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, modelon të ardhmen”, financuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Qendra Multifunkionale Rinore Berat është struktura kryesore për të rinjtë në Bashkinë Berat. Qendra është e vendosur në një godinë katër-katëshe prej 400 m², e ndërtuar posaçërisht për të rinjtë. Në katin e parë/përdhës, të rinjtë ushtrojnë talentin e tyre në pikturë. Muret e këtij kati janë quajtur “Mure Lëvizëse” pasi të rinjtë pikturojnë në këto mure duke u ushtruar. Kështu, radhazi ato bëjnë punimet e tyre në mur të cilat qëndrojnë një kohë të caktuar deri sa të rinjtë të tjerë të punojnë sërish në to. Muri lyhet herë pas here, për t’u bërë gati për krijuesit e rradhës. Në këto mure të rinjtë lënë mesazhe për njëri tjetrin. Në këtë kat janë vendosur 10 tavolina pune. Në katin e dytë, të rinjtë argëtohen, luajnë pingpong, minifutboll apo shah. Në katin e tretë, realizohen aktivitete të

ndryshme, si diskutime, trajnime dhe seminare, simulime të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, diskutime për programet rinore apo si ta zhvillojmë qytetin/bashkinë, etj. Ky kat është konceptuar si një vend pune, ku të rinjtë mund të punojnë në kohë të lirë. Ata mund të gjenerojnë ide dhe të shkruajnë projekte të vogla për të rinjtë. Në këtë ambient ndodhet dhe recepsioni/zyra e qendrës, në të cilën ekpozohen dhe shpërndahen materiale promovuese të qendrës dhe të bashkëpunëtorëve të saj. Në katin e katërt organizohen koncerte, shfaqje apo priten miq të rëndësishëm. Nga ky kat ke mundësi të shohësh Beratin në 360 gradë, shikon Malin Partizan, Kalanë e Beratit me 2 lagjet muzeale, si Gorica dhe Mangalemi (të cilët janë trashëgimi e UNESCO-s), kodrat e gjelbëruara ku është vendosur qyteti i ri dhe Malin e Tomorrit.

Qendra është e pajisur me mjetet e nevojshme përfshirë 20 skrivani, 7 kompjutera (4 desktop dhe 3 laptop), 1 qendër zëri, 1 mikrofon, 1 ekran, 2 tavolina pimpongu, 2 tavolina minifutbolli, 8 tavolina shahu, 300 karrike, dhe 5 kolltuqe.

Në një zyrë të dedikuar në ambientet e Qendrës Multifunkionale Rinore ndodhet Zyra e Këshillimit të Karrierës, një ambient i dedikuar për ofrimin e shërbimit të Këshillimit të Karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës është një shërbim, i cili ofron shërbime komunitare për të gjithë banorët e Beratit, me fokus tek të rinjtë dhe të rejat (15 -29 vjeç), të cilët dëshirojnë të informohen apo këshillohen mbi mundësitë e tyre për arsim, formim profesional dhe zhvillim karriere. Shërbimet e ofruara nga zyra përfshijnë një gamë veprimtarish në shërbim të nxënësve të arsimit parauniversitar për orientimin dhe këshillimin për karrierën:

- Sesione informimi e trajnimesh;

- Teste të vlerësimit të interesit;
- Këshillim individual e në grup;
- Veprimtari promovuese të profesioneve.

Sipas organogramës së Bashkisë Berat, strukturat të tjera që lidhen direkt ose indirekt me ndërhyrjet për të rinjtë përfshijnë:

Drejtoria e Shërbimit Social, e cila përfshin Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Pagesave të Aftësisë së Kufizuar, Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe Qendrën Komunitare. Sektori i Shërbimeve Sociale përfshin edhe Specialistin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Specialistin për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje. Qendra Komunitare ka në përbërjen e saj psikologun dhe tre punonjës këshillimor. NJMf mbështet të rinjtë e rikthyer nga emigrimi duke lehtësuar shërbimet për ofrimin dhe garantimin e aksesit në drejtësi dhe të rinjtë me tendencë për të emigruar në mënyrë të parregullt nëpërmjet sesioneve ndërgjegjësuese mbi risqet, po ashtu ofrimin e ndihmës juridike falas për këtë kategori. Të rinjtë në konflikt me ligjin mbështeten duke ngritur plane individuale sociale për ri-integrimin e tyre dhe fuqizimin e familjes. Ndër objektivat kryesor të kësaj drejtorie është integrimi i të rinjve, persona me aftësi të kufizuara nëpërmjet punësimit të përshtatur me aftësitë dhe kapacitetet; si një mundësi që personat me aftësi të kufizuara të zhvillojnë shprehjet e tyre profesionale, të fitojnë përvojë pune dhe të kuptojnë më mirë detyrat e një pune të veçantë.

- **Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve**, e cila përfshin Sektorin e Turizmit me 6 punonjës dhe Sektorin e Aktiviteteve me 6 punonjës.
- **Drejtoria e Integritit European dhe Projekteve**, e cila ka një staf prej 6 punonjësish (Drejtori, Përgjegjësi i Sektorit të Projekteve dhe Integritit European, specialisti për integrimin European dhe marrëdhëniet me jashtë, dy specialistë të planifikimit dhe zhvillimit të projekteve strategjike dhe specialistin e statistikës). Ndër projektet kryesore të zbatuara në Bashkinë Berat që ndikojnë cilësinë e jetesës tek të rinjtë janë:
 - ✓ Qëndrojmë sëbashku - Projekti është duke u implementuar përgjatë vitit 2024 dhe ofron shërbime për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve e të rinjve në situatë rruge e rreziku, si pjesë e target-grupit që ndikohet.
 - ✓ Berati Riciklon - Ndarja e Mbetjeve në Burim: Ky projekt ka nisur implementimin në fillim të këtij viti dhe të rinjtë e shkollave të mesme e të rinj vullnetarë të projektit do të angazhohen sipas një plani të koordinuar paraprakisht për të qenë mentor në edukimin dhe përcjelljen e informacionit tek bashkëmoshatarët e tyre.
 - ✓ Eurocultural-link është një projekt që synon nxitjen ekonomike duke ngritur inkubatorë biznesi në funksion të sipërmarrjeve të reja në sektorin kulturor dhe profesioneve përkatëse të ekoturizmit.
 - ✓ Parku Rekreativ «Dua të luaj» është një projekt që synon rritjen e mirëqenies së komunitetit dhe dhënien e mundësisë për zhvillimin motorik të brezave të rinj dhe përfshin 300 pemë, kënd lojërash, pistë vrapimi, kalçeto,

fushë basketboll, fushë volejboli, fushë tenisi, fushë padel, ambiente të gjelbra dhe stola për të pushuar.

- **Spektori i bibliotekës “Vexhi Buharaja”, galeria e arteve “Eduart Lear”, dhe qendra “Lira”.**
- **Klubi i shumësporteve.**

Gjatë vitit kalendarik 2024, janë realizuar disa aktivitete dhe projekte të rëndësishme për të rinjtë nga Bashkia Berat si:

- Takime të rregullta të KVR;
- Organizimi i Simultanes së Shahut - Edicioni i katërt (me pjesëmarrjen mesatarisht të 30 të rinjve për edicion);
- Programe të ndryshme të vullnetarizmit;
- Programi i Guidave Turistike, si një përpjekje për të përcjellë njohuri bazë të aftësisë të guidave tek të rinjtë të shkollave të mesme, me synimin për ta zgjeruar e formalizuar më tej;
- Shkolla Verore me Shkollat Qendër Komunitare (Edicioni i dytë);
- Takime promovimi dhe këshillimi karriere;
- Panairi i Profesioneve (Edicioni i parë);
- Java e Kulturës Beratase (Edicioni i tretë).

Nga Qendra Multifunktionale Rinore janë realizuar aktivitete të shumta, si:

- Edukimi elitari me lektorë të ndryshëm të përqëndruar në këshillim karriere apo dhe diskutime të ndryshme mbi arkitekturën etj.

- Edukimi dhe përkujdesja për ambientin, ndërgjegjësim dhe pastrim të lagjeve muzeale me nxënësit e shkollës verore. Të rinjtë bashkëpunojnë për Beratinqytet të gjelbërt.
- Projekti «Art & Recycling» që synon përdorimin e materialeve të riciklueshme duke përdorur krijimtarinë/artin. 30 të rinjtë sfiluan para prindërve të tyre dhe turistëve me veshje që i kishin krijuar vetë.
- Projekti «Art & Zeje» që synon promovimin e vlerave dhe të traditave si pasuri kolektive. Të rinjtë të veshur me kostume popullore promovojnë kostume tradicionale të burrave dhe grave, elementët e të cilave u diskutuan në takime publike.
- Ekspozita «Qyteti Im» i realizuar në kuadër të Programit të «Vullnetarizmit Rinor» ku të rinjtë ekspozuan 100 fotografi me diçitura personale, sipas impresionit për secilën prej tyre.
- Në kuadrin e programit të mësipërm është realizuar edhe projekti «Njohja e qytetit» ku 50 të rinjtë dhe fëmijë të shoqëruar nga prindërit përshkruan qytetin me bicikleta për ta njohur atë, për t’u argëtuar duke bërë sport, dhe për të promovuar lëvizjen me bicikletë në vend të makinës.

Bashkia Berat është e varur në një masë të konsiderueshme nga aktorët e tjerë për realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me fuqizimin dhe pjesëmarrjen qytetare, mirëqenien fizike dhe mendore, apo aftësimin dhe punësimin e të rinjve. Të ardhurat nga transferta e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar mbulojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të bashkisë për realizimin e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara. Ndërsa të ardhurat e veta të programuara për buxhetin e bashkisë për vitin 2025 janë 590,530 mijë lekë, ose rreth 43% të të ardhurave dhe 47% të shpenzimeve të planifikuara që janë 1,246,823 mijë lekë. Bashkia bashkëpunon me

donatorë të ndryshëm të vendit dhe të huaj për realizimin e aktiviteteve të ndryshme. Për vitin 2024, totali i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2024 është planifikuar 644,977 mijë lekë, nga të cilat 13,506 mijë lekë janë fondet e financimit të përkohshëm të rimbursueshëm nga donatorët. Varësia nga pushteti qendror dhe aktorët e tjerë vështirëson zhvillimin dhe financimin e politikave të reja nga ana e bashkisë dhe rritjen e shpenzimeve për kulturën dhe rininë.

Përsa i përket shpenzimeve, pjesën më të madhe e zënë shpenzimet operative (për personelin, mirëmbajtjen dhe të tjera transferata), si dhe për infrastrukturë, siç janë qendrat, parku rekreativ, etj. Shpenzimet kapitale zënë 15% të totalit të shpenzimeve.

Në buxhetin e planifikuar për vitin 2024, për programin Arsimit & Kujdesit Social shkon 29 % e buxhetit vjetor, ose shuma 406,098 mijë lekë dhe për programin Turizmi, Kultura dhe Sportet shkon 10.7 % e buxhetit vjetor, ose shuma 149,209 mijë lekë. Shpenzimet kapitale të planifikuara për Programin Arsimit & Kujdesit Social janë 20,170 mijë lekë ose 9.2% dhe për programin Turizmi, Kultura dhe Sportet janë 32,434 mijë lekë ose 14.8%.

3. NEVOJAT E TË RINJVE NË BASHKINË BERAT

Në kuadrin e zhvillimit të Planit, intervista individuale fizike dhe online u zhvilluan me të rinj dhe përfaqësues të strukturave të bashkisë që punojnë me rininë/në sektore dedikuar të rinjve. Me këta të fundit u organizuan edhe grupe fokus. Në përgjithësi, të rinjtë

dhe përfaqësuesit e Bashkisë janë në të njëjtat linja lidhur me nevojat e të rinjve në fusha të ndryshme, sikurse janë pëmbledhur më poshtë.

3.1. Çfarë kërkojnë të rinjtë?

Prioritetet dhe aktivitetet për organizimin, fuqizimin, dhe pjesëmarrjen rinore

Prioritetet	Aktivitetet
<ul style="list-style-type: none"> Vazhdimësi në bashkëpunimin midis bashkisë, shkollës, dhe organizatave rinore/për rininë. Shtim i programeve/projekteve rinore të realizuara mbi qeverisjen e mirë dhe pjesëmarrjen/ konsultimin e të rinjve në vendimmarrje. Masa të vazhdueshme dhe eksplorim i qasjeve të reja për garantimin e pjesëmarrjes/konsultimin e të rinjve në vendimmarrje. Rritja e numrit të të rinjve pjesëmarrës në strukturat vendimmarrëse të pushtetit vendor. Krijimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë dhe mbështetje për organizimet e nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> Programe për zhvillim kapacitetesh. Informimi dhe sensibilizimi i të rinjve për rëndësinë e angazhimit social dhe pjesëmarrjen aktive në jetën e komunitetit. Më shumë mundësi dhe hapësira për aktivitete rinore. Organizimi i debateve rinore. Krijimi i një platforme online ku të rinjtë të informohen dhe të diskutojnë mbi çështje të ndryshme. Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Takime të hapura midis të rinjve dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor. Bashkëpunimi në përkrahjen e organizatave rinore. Bashkëpunimi për mbështetjen financiare për projektet rinore.

Prioritetet dhe aktivitetet për mirëqenien aktive, të shëndetshme, fizike, sociale & mendore të të rinjve

Prioritetet	Aktivitetet
